



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës*  
*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke*  
*Ministry of Education and Science*

**Kërkesë për shprehje interesi**

**NUMRI I PROJEKTIT:** (P179656)

**EMRI I KREDISË:** PROJEKTI PËR EDUKIMIN DHE KUJDESIN NË FËMIJËRINË E HERSHME PËR KAPITALIN NJERËZOR TË KOSOVËS

**DATA:** 23 mars 2026

**Specialist i Menaxhimit Financiar**

**HISTORIKU**

Projekti për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme dhe projekti i kapitalit njerëzor të Kosovës është hartuar për të çuar përpara prioritetet kryesore kombëtare në arsimin dhe kujdesin e fëmijërisë së hershme (EKFH), përfshirjen sociale, barazinë gjinore dhe zhvillimin e ndërgjegjshëm për klimën.

Në mënyrë specifike, Projekti përforcon përpjekjet e Kosovës për të zgjeruar qasjen e barabartë në EKFH me cilësi të lartë, për të fuqizuar gratë dhe grupet e marginalizuara, për të forcuar kornizat institucionale dhe për të mbështetur zhvillimin e orientuar drejt klimës brenda prioriteteve strategjike si të Qeverisë ashtu edhe të Bankës Botërore.

Pavarësisht këtyre përpjekjeve, qasja në shërbimet e EKFH mbetet e kufizuar dhe e pabarabartë në të gjithë vendin. Shkalla e regjistrimit për fëmijët nën moshën pesë vjeç është të ulëta dhe, ndërsa pjesëmarrja në arsimin parashkollor (mosha 5-6 vjeç) është rritur, cilësia dhe kohëzgjatja e shërbimit mbeten shqetësime. Aty ku ekzistojnë shërbime, ato karakterizohen nga ndryshueshmëria në standardet e infrastrukturës, kapacitetin e fuqisë punëtore, praktikat pedagogjike dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë. Këto sfida prekin në mënyrë disproporcionale

fëmijët në zonat rurale dhe ata nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, duke përforcuar boshllëqet në të nxëniet e hershëm dhe pabarazitë afatgjata. Në përgjigje të kësaj, Qeveria e Kosovës, me mbështetjen e Bankës Botërore, po zbaton Projektin e Edukimit dhe Kujdesit të Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës (P179656). Objektivi i zhvillimit të projektit (OZHP) është të përmirësojë cilësinë dhe qasjen e barabartë në shërbimet e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme në Kosovë. Projekti është strukturuar rreth katër komponentëve që përforcojnë reciprokisht që adresojnë kufizimet si të furnizimit ashtu edhe të sistemit në sektorin e EKFH-së.

Komponentët e Projektit janë: Komponenti: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të EKFH; Komponenti 2: Nxitja e integritit multi-sektorial në ofrimin e shërbimeve të EKFH; Komponenti 3: Rritja e qasjes së barabartë në shërbimet e edukimit dhe arsimimit në fëmijërinë e hershme (përfshirë Nënkomponentin 3.3 – Programi i Kuponëve); Komponenti 4: Menaxhimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Projektit.

### **Përgjegjësitë e Specialistit të Menaxhimit Financiar**

Specialisti i Menaxhimit Financiar do të jetë përgjegjës për menaxhimin financiar, duke përfshirë buxhetimin, kontabilitetin dhe përgatitjen e raporteve financiare në përputhje me KFMIS dhe rregulloret e Bankës Botërore. Specialisti i Menaxhimit Financiar (MF) do të jetë pjesë e Njesisë së Zbatimit të Projektit (NjZP) të Projektit të Edukimit dhe Kujdesit të Fëmijërisë së Hershme për Kapitalin Njerëzor të Kosovës. Specialisti i Menaxhimit të Financave do t'i raportojë Koordinatorit të Projektit, ndërkohë që bashkëpunon ngushtë me ekipin e NJZP-it dhe MASH-in.

*Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore janë përcaktuar në Kushtet e Referencës për këtë detyrë.*

### **Kualifikimet e kërkuara**

- Një diplomë në kontabilitet, ekonomi, menaxhim. Një diplomë pasuniversitare (p.sh., MA ose më i lartë) do të konsiderohet aset.
- Minimum 7 vjet përvojë profesionale në menaxhimin financiar ose role të disbursimit, mundësisht brenda projekteve qeveritare, përvoja e mëparshme në punën me projekte të Bankës Botërore do të konsiderohet si një avantazh.
- Përvojë e provuar pune me rregulloret dhe sistemet financiare të Qeverisë së Kosovës (KFMIS).
- Njohja e mirë e gjuhës angleze dhe shqipe është e detyrueshme (njohja e gjuhës serbe është përparësi).

### **Periudha e Performancës**

Specialisti i Menaxhimit Financiar do të punojë me orar të plotë dhe kohëzgjatja e kontratës pritet të fillojë në maj 2026 dhe të vazhdojë deri në maj 2027. Kohëzgjatja e kontratës do t'i nënshtrohet performancës së kënaqshme të rënë dakord gjatë një vlerësimi zyrtar të planifikuar në fund të çdo

viti, ku 6 muajt e parë do të jenë periudhë provuese. Shpërblimi do të paguhet në bazë të pagës mujore të përcaktuar në kontratë. Konsulenti pritet të fillojë shërbimet pas nënshkrimit të kontratës.

### **Procesi i përzgjedhjes:**

Individë me përvojë dhe të kualifikuar do të përzgjidhen sipas dispozitave të Rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve të Investimeve (FPI), korrik 2016, bazuar në një thirrje të hapur.

### **Kriteret e Vlerësimit:**

- Kualifikimi i përgjithshëm - 30 pikë
- Përvojë specifike në lidhje me detyrën – 70 pikë

Konsulentët individualë të interesuar mund të marrin informacione të mëtejshme në adresën më poshtë gjatë orarit të punës: 08:00 - 16:00 (nga e hëna deri në të premten)

Shprehja e interesit mund të dorëzohet në adresën e shënuar më poshtë deri më **31 mars 2026, ora 16:00**: [apliko.mash@rks-gov.net](mailto:apliko.mash@rks-gov.net)